

V E N D I M

Nr.684, datë 28.10.1998

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 446, DATË 9.7.1998 “PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”

Në mbështetje të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.446, datë 9.7.1998 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin I “Procedura për përcaktimin e formulës së privatizimit”, pas pikës 3C, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“4. Në shoqëritë tregtare, 100 për qind shtetërore, kur ka të dhëna të plota për pjesën e aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe për punonjësit e shoqërisë, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka të drejtë të përcaktojë paketën e aksioneve, që i ofrohet blerësit dhe të nxjerrë urdhrin përkatës të privatizimit të saj. Ky urdher i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, për të filluar procedurat për shitjen e këtyre aksioneve”.

2. Në kapitullin II, “Procedura për privatizimin e paketave të aksioneve”, në pikën 1, fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

“Afati i publikimit do të jetë 30 ditë”.

3. Në kapitullin II, “Procedura për privatizimin e paketave të aksioneve”, në pikën 9, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Në vazhdim, procedura rifillon nga pika 1, kapitulli II i këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko